

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“STRUMI TAXI” Sh.p.k.

Sot, më date **20.12.2023**, ne te nenshkruarit:

- **Kudret Strumi** lindur ne Strum, Fier me 21/03/1955, shtetas shqiptare, banues ne Lushnje , identifikuar me karten e identitetit me Nr. 038871545, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar; në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” kam vendosur të themelojme një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar **“STRUMI TAXI” Sh.p.k.** (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

Neni 1

Emri i Shoqërisë është: **“STRUMI TAXI” Sh.p.k**

Neni 2

(1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën:-Lagja “18 Tetori”, rruga “Hysni Gorovelli”, godine dyekateshe me nr. 14 ,Bashkia Lushnje.

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: *strumitaxi@yahoo.it*
Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

Neni 3

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 10 vjet dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Objekti i veprimtarise se shoqerise

Neni 4

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :

-Sherbim taxi,etj.

-Megjithate shoqëria ka te drejte qe te shtoje dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100 000** (njqindmije) lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Kudret Strumi**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **100 000** leke që përbën **100 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.



Kontributi i ortakëve do të jetë në para .

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themelor mund të bëhet vetëm pasi Asambleja e ortakëve me shumicë e ka dekretuar këtë dhe për më tepër të gjithë ortakët janë të detyruar që ta repektojnë dhe të kontribuojnë në para ose në natyrë në bazë të vendimit të shumicës së asamblese

Neni 7:

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen përmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) shitblerjes; (me të drejtën e parablerjes nga ana e ortakëve).
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjrisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, përse nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjrisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8

Organi Vendimarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve ,përfshirimi nga e drejta e votës dhe të tjera modalitete për funksionimin e organit vendimarrës përcaktohen në statutin e shoqërisë.



Neni 9

Administrimi

Aministrator i shoqerise emerohet Z. **Erald Strumi** lindur ne Lushnje, me 17/03/1989,shtetas shqiptare,banues ne Lushnje , identifikuar me karten e identitetit me Nr. 032934294,madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i zgjedhur per nje periudhe 5 vjecare me te drejte rizgjedhje.

Kompetencat dhe pergjegjesite e Administratorit jane te percaktuara qarte ne statutin e shoqerise.

Neni 10

Viti financiar-ekspertët

Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Përgjastimisht, viti i pare financiar fillon nga data e rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, atë gjithëvjetor dhe atë ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gjë te tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pregatit raportin me shkrim per nxierien e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per atë per kontrollet periodike te ushtruara, te cialt eshte i detyruar qe tja paraqese e ta dorëzoje ne kohë ortakëve per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore qe ka.

Neni 11

Prishja-riorganizimi i shoqerise

Modalitetet per prishjen dhe riorganizimin e shoqerise jane te percaktuara ne statutin e shoqerise ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqerite tregtare" i Ndryshuar.

Neni 12

Akti i Themelimit eshte hartuar ne 4 kopje origjinale.

ORTAKET E SHOQERISE

KUDRET STRUMI

Kudret Strumi
[Signature]